

Roald HYSA

## ARTI ISLAM NDËR SHEKUJ

*“Një përpyetje për të përmbledhur në një shkrim principet dhe periudhat kohore më të rëndësishme të artit të një civilizimi mbinacional”.*

**Prof. dr. Ismail Faruki**

Arti islam është ndoshta manifestimi më i hapur i një qytetërimi tepër kompleks që shpesh nga jashtë u duket të tjerëve si një qytetërim enigmatik. Përdorimi i ekuilibruar i ngjyrave në formë dhe në vizatim e bën artin islam që të krijojë një impakt të menjëhershëm në sytë e shikuesit. Estetika e rreptë e këtij arti i tejkalon distancat kohore dhe të hapësirës, po aq sa edhe ato të gjuhëve, të kulturave dhe të besimit. Arti islam jo vetëm që të fton në një shikim të përafuar, por, gjithashtu, ai e fton shikuesin të mësojë më tepër. Termi *art islam* mundet që t'i ngatërrojë disa njerëz. Ky term nuk përshkruan vetëm atë lloj arti të krijuar veçanërisht në shërbim të Fesë Islame, por ai, gjithashtu, mund të karakterizojë edhe artin e përditshëm të prodhuar nën ndikimin apo sundimin islam, cilado ka qenë tendenca e artistëve apo e patronëve. Ky term në vetvete të sugjeron një art të unifikuar në stil dhe në qëllim. Megjithatë, ai është një art me të vërtetë shumë dinamik, i cili shpesh herë shënjohe nga karakteristika të forta rajonale. Po aq sa ka ndikime domethënëse të kulturave të tjera, ai ruan një koherencë të përgjithshme, e cila i bën të dallueshme kufijtë e tij të gjerë kohorë e gjeografikë. Për zhvillimin e këtij arti të rrallë, një rëndësi të madhe paraqet vetë Islami, i cili ka ushqyer krijimin e një kulture të dallueshme pamore me gjuhën e saj të posaçme artistike. Kaligrafia është elementi më i rëndësishëm dhe më i përhapur i artit islam. Ajo është konsideruar gjithmonë një formë e lartë arti, për shkak të bashkëshoqërimit të saj me Kuranin Famëlartë, i cili shkruhet në arabisht. I gjithë ky shqetësim

për bukurshkrimin shtrihet në të gjitha artet, duke përfshirë dorëshkrimet e zakonshme, mbishkrimet nëpër pallate dhe ato të aplikuara në metale, poçeri, gur, xham, dru dhe tekstile – po ashtu edhe në popujt joarabfolës brenda arealit islam, gjuhët e të cilëve, si: persishtja, osmanishtja, urdhja etj., u shkruan me alfabet arab. Një karakteristikë tjetër e artit islam është parapëlqimi për të mbuluar sipërfaqet e ndryshme me gjedhe gjeometrike apo bimore. Vizatime komplekse gjeometrike, po ashtu edhe gjedhet me zbukurime bimore (arabeskat), të krijojnë përshtypjen e një përsëritjeje të pafundme që, sipas shumë studiuesve, të nxisin të meditoresh mbi natyrën e pakufishme të Zotit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se këto lloje zbukurimi në artin islam u ngritën në një shkallë të lartë zhvillimi, edhe pse në kontekstin fetar nuk lejohet paraqitja e figurave frymore. Megjithatë, paraqitja e figurave nuk është se ka munguar plotësisht në këtë art, por duhet pasur parasysh se figurat frymore janë ende të ndaluara rreptësisht në zbukurimin e xhamisë, si institucioni themelor i kultit, i cili i shërben një adhurimi të pastër të Zotit në Islam. Por figurat frymore nuk është se kanë munguar krejtësisht në këtë art, vetëm se ato nuk janë praktikuar nëpër institucionet fetare.

Në kulturën islame, të ashtuquajturat arte dekorative sigurojnë mjetet themelore për shprehjen artistike, në të kundërt me atë perëndimor, ku piktura dhe skulptura dallojnë. Dorëshkrime të ilustruara, tekstile dhe qilima, metale të larzuara, xham me lule, qeramikë e glazuruar, druri dhe guri i gdhendur, të gjitha këto përthithën energjitë krijuese të artistëve, duke u bërë kështu forma arti shumë të zhvilluara. Në këto punime përfshihen sende të jetesës së përditshme në shkallë të vogël, si gota kristali delikate, deri edhe në ato të një shkalle më të madhe të tipit monumental, pllaka qeramike të glazuruar për fasadat e ndërtesave të ndryshme. Këto objekte prodhoheshin me shumë përpikmëri dhe zbukuroheshin me shumë kujdes, shpesh me materiale të rralla dhe të kushtueshme, duke na sugjeruar kështu se njerëzit që i porosisnin kërkonin ta rrethonin vetveten me gjëra të bukura.

Kujdestaria mbretërore ka luajtur një rol të rëndësishëm në artin islam, po aq sa edhe në kulturat e tjera. Ndërtimi i xhamive dhe i medreseve, duke përfshirë këtu zbukurimin dhe furnizimin

e tyre, ishte përgjegjësi e sundimtarëve dhe privilegj i oborrtarëve të lartë. Këto ndërtime nuk ishin në funksionim vetëm për nevojat shpirtërore të muslimanëve, por kanë shërbyer edhe si vende arsimimi dhe bamirësie. Patronazhi mbretëror mbi artin e ashtuquajtur shekullar ishte, gjithashtu, një veçori e sundimtarëve të mëdhenj muslimanë për të treguar madhështinë e oborrit dhe epërsinë e gjendjes së tyre. Fakte të patronazhit mbretëror mbi artet janë të dokumentuara nëpër libra të posaçëm dhe, që nga shek. XIV, këto fakte janë të dokumentuara me hollësi.

Natyrisht jo të gjitha punimet e artit islam janë sponsorizuar nga oborret. Në fakt, një pjesë e madhe e objekteve dhe dorëshkrimeve që gjenden nëpër koleksionet e muzeumeve, e kanë origjinën tjetërkund. Punime të tilla arti, si: poçeria, artikujt metalikë, qilima dhe tekstile shihen si prodhim i patronazhit të klasës së mesme qytetare. Megjithatë, këto objekte shpesh pasqyrojnë të njëjtin stil dhe përdorin të njëjtat forma e teknika të përdorura nga arti oborrtar.

Arti islam, qoftë në suazën urbane apo të oborrit, apo në kontekst fetar, në përgjithësi është prodhim i artistëve anonimë. Një përjashtim i dukshëm mund të bëhet në sferën e artit të librit. Emrat e disa kaligrafëve janë shumë të mirënjohur, fakt që nuk përbën befasi, duke parë përparësinë që i jepet fjalës së shkruar në Islam, siç mund të jetë rasti i disa kaligrafëve të atashuar nëpër oborre të posaçme. Identifikimi i këtyre artistëve është bërë në bazë të shembujve të sigluara apo që u atribuohen atyre, apo edhe në bazë të referencave tekstuale. Duke parë numrin e madh të shembujve ekzistues, vetëm një pakicë firmash janë gjetur në punimet e metalit, poçerisë, në gdhendjet e gurit e të drurit dhe në tekstile. Këto firma, që shfaqen të kombinuara edhe me të dhëna nga burime tekstuale bashkëkohore, sugjerojnë që familje artistësh, shpesh për shumë breza, janë specializuar për një lloj punimi të veçantë ose teknikë.

Siç mund të vërehet nga kjo temë, arti islam formon një subjekt më vete, të gjerë shumë dhe kompleks. Ndërsa kemi shumë mjete të ndryshme për ta klasifikuar artin islam, galeria e artit "Los Angeles County Museum of Art" ka ndjekur ndarjen kronologjike në katër periudha. Me këtë sistem klasifikimi është synuar të theksohet uniteti i përgjithshëm i artit islam brenda secilës

periudhë, ndërkohë që merr parasysh dinastitë e panumërta, zëvendësimi i njëpasnjëshëm i të cilave ka shënjuar historinë islame dhe që patronazhi i tyre ka pasur një impakt të rëndësishëm në zhvillimin e artit islam. Periudha e hershme islame, nga shekulli i shtatë deri në shekullin e dhjetë, shënon origjinën e Islamit, krijimin e një komonuellthi fetar, politik dhe kulturor; si dhe formimin e një stili të ri në art. Në periudhën e hershme mesjetare, nga shek. XI e deri në mesin e shek. XIII, dhe në periudhën e vonshme mesjetare, nga mesi i shek. XIII deri në shek. XV, u shfaqën fuqi të ndryshme rajonale, të cilat kultivuan forma të ndryshme të shprehjes kulturore. Dhe në fund, periudha e vonë islame, shek. XVI e deri në fund të shek. XVIII, ishte koha e perandorive të mëdha, në të cilat patronazhi i dinastive të fuqishme, më tepër se kurrë, ndihmoi në kultivimin dhe modelimin e stileve artistike.

“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën” - kjo është një thënie e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, rreth 1400 vjet më parë. Ai, gjithashtu, ka thënë “Allahu, kur kërkon nga ju që bëni një punë, ta bëni atë sa më mirë”. Këto thënie profetike u dhanë një shtytje muslimanëve për të zbukuruar dhe stolitur vendet e tyre të faljes, shtëpitë, deri edhe sende të jetesës së përditshme. Arti islam i jep një theks të veçantë zbukurimit, më tepër se sa tendencës së artit për art. Siç u përmend edhe më sipër, ndërsa emrat e prodhuesve të punimeve të stërholluara në artin islam mund të mos kenë mbijetuar, punimet e tyre janë përdorur si prototipe dhe modele në të cilat artistët dhe zejtarët e tjerë kanë modeluar punimet e tyre, ose nga të cilat morën shtysat për punime të ngjashme.

Një shembull i kësaj është një çantëz e stolitur me qëndisma kryq dhe e zbukuruar me monedha. Kjo çantëz mban një shishkëz që nuk shihet, të cilën gratë beduine palestineze mbajnë *kohlin*, për të lyer sytë. Arte të tilla si qëndistaria dhe thurjet elegante me grep ishin një shfaqje e zakonshme ndërmjet grave muslimane në të shkuarën, shfaqje që vazhdon të jetë në disa vende të botës muslimane. Kjo ka kaluar nga nëna te vajza, e cila, duke u rritur së bashku me nënën e vet, ka përgatitur me punëdore pajën përpara se të martohej: çarçafët e shtratit, peshqirë, rrugica për falje, jorganë, mbulesa tavoline dhe gjëra të ndryshme dhëndërie për t'i marrë me vete në shtëpinë e re.

Sot arti i të qepurit dhe i thurjes së qilimave gjendet në Turqi,

Iran, Siri, Pakistan, Indi, Egjipt dhe Marok, ku trashëgimia e Islamit mbetet e gjallë dhe e fuqishme.

## Arti i periudhës së hershme islame

(622- shek. XI)

Ndërsa periudha e Islamit ka një datë të mirënjohur dhe të përcaktuar, e cila fillon me shpërnguljen e Profetit Muhamed nga Meka në Medine në vitin 622, lindja e artit islam është shumë e vështirë për t'u datuar. Pak a shumë mund të datohet në shek. I hixhri të sundimit islam. Shumë pak dihet për kulturën materiale të Arabisë në fillim të përhapjes së Islamit jashtë saj, ku tokat bizantine dhe sasaniane të përthithura rishtazi në shtetin musliman kishin traditat e tyre autoktone. Kështu që është shumë e vështirë të bësh dallimin midis artit të hershëm islam dhe atij paraislam.

Përthithja dhe përshtatja imagjinative e temave dekorative dhe motiveve paraislame, po aq sa teknikat, stilet dhe format, karakterizojnë pjesën më të madhe të kësaj kohe. Në të gjitha sendet e ruajtura nëpër muzeume të kësaj periudhe, vërehet ndikimi romako-bizantin.

Shembuj të tjerë në qelq, punime metalike, dru i gdhendur dhe tekstile nëpër koleksione të ndryshme pasqyrojnë një trashëgimi të përzier. Deri edhe në ndërtimet më të rëndësishme umajade, siç është ai i Kubetu Sakhra (Xhamisë së Shkëmbit), funksioni dhe qëllimi i të cilit është qartësisht islam, e demonstrojnë këtë proces formues, që kombinon dhe transformon elementet romako-bizantine dhe ato sasanide. Me lindjen e shtetit islam dhe përhapjen e fesë dhe me stabilizimin gradual të tij, një art unik islam nisi të shfaqet.

Zbulimi i Kuranit dhe, më pas, kodifikimi i tij në formën e shkruar pati një ndikim të pallogaritshëm në zhvillimin e shkrimit arab dhe në prodhimin e librave në shek. I hixhri. Në fillim të erës abaside, për Kuranin ishte arritur një marrëveshje standardi, e cila mbizotëroi për shekuj me radhë. Megjithëse u përdorën disa stile shkrimi në shek. VII-VIII, nga shek. IX i ashtuquajturit shkrim kufik u zuri vendin atyre në prodhimin e Kuranit. I emërtuar sipas qytetit të Kufes, qytet në jug të Irakut, ai është krejtësisht

i dallueshëm, shkrim drejtvizor dhe, si të gjithë shkrimet arabe, fillon nga e djathta në të majtë. Kopje të hershme të Kuranit me shkrim kufik, përgjithësisht i gjen të shkruara me bojë të zezë ose kafe të errët.

### **Periudha e hershme mesjetare** (shek. XI e deri në mesin e shek. XIII)

Duke kombinuar format, teknikat dhe stilet inovative me ato të konceptuara më parë, periudha e hershme mesjetare shumë shpesh shenjohe nga karakteristikat rajonale. Krahasuar me artin e hershëm islam, punimet artistike të kësaj periudhe kanë një përdorim më të madh të formave dhe zbukurimeve të figurshme. Mirëqenia dhe begatia materiale që arritën Egjipti Fatimid dhe Siria gjatë kësaj periudhe, pasqyrohen në bollëkun artistik. Dukshmërisht Fatimidët patën shije tepër pedante për prodhimet e artit dhe enë me gdhendje të ndërlikuara prej shkëmbi kristalin, një lloj kuarci i pangjyrë transparent, sipërfaqja e të cilit fërkohej deri në shkëlqim.

Një tjetër kriter për të treguar statusin shoqëror ishin edhe veshjet personale. Tekstile nga shekujt e parë të erës islame kanë mbijetuar kryesisht në formën e fragmenteve, duke përfshirë këtu edhe tirazin, veshje me mbishkrime të qëndisura e të zbukuruara, mbi të cilën shkruhej emri dhe titulli i sundimtarit. Arti i Spanjës Islame të kësaj periudhe është, në një farë mënyre, më pak novativ dhe energjik sesa ai i prodhuar gjetkë. Kjo i dedikohet edhe izolimit relativ të Spanjës dhe Afrikës Veriore nën sundimin konservator të almoravidëve dhe almohadëve. Ndoshta, për shkak edhe të pasigurisë së shkaktuar nga Rekonkuista e krishterë, e cila tashmë e kishte zëvendësuar në pjesë të ndryshme të vendit sundimin musliman, arti i shek. XI dhe XII duket se sheh mbrapa te kryeveprat e hershme të kohës së artë të Spanjës Islame të shek. IX-X. Në Iran, valët e fiseve turkmene, që emigruan nga stepat e Azisë Qendrore, adoptuan gjuhën dhe kulturën persiane, të cilën e morën nën mbrojtje dhe e përforcuan. Lulëzimi i madh i artit në këtë periudhë ka të bëjë më tepër me oreksin e elitës sunduese turke për kulturën persiane se sa me etnicitetin e tyre. Zbukurimet arkitekturore, libërlidhja, tekstilet, qelqi, punimet metalike dhe

poçeria, të gjitha këto arritën në një shkallë të lartë, të pasuruara nga një fjalor dekorativ që shpesh mbizotërohet nga paraqitjet e figurshme. Zbukurimet figurative ishin aq mbizotëruese, sa që transformuan deri edhe mbishkrimet në arabisht, në të cilat filluan të shfaqeshin përherë e më tepër figurat humane dhe të kafshëve, ndërsa vetë germat u transfiguruan në krijesa. Ky parapëlqim për shkrime “të animuara” nuk infektoi mbishkrimet e prodhuara në kontekstin fetar, të cilat, kur shkruheshin në kufik, gjithashtu transformoheshin dhe zbukuroheshin me forma abstrakte, ose vizatime bimore, apo edhe duke i gërshetuar boshtet vertikale të germave. Punimet metalike të kësaj periudhe gjithashtu tregojnë një rafinim dhe tejkalim të teknikave të hershme. Larzimi i bronzit dhe i tunxhit me metale të vlefshme u praktikua në periudhën e hershme islame, por në një shkallë të kufizuar.

### **Periudha e vonët mesjetare** (mesi i shek. XIII deri në shek. XV)

I ushqyer nga pushtimet mongole të messhekullit XIII, ngulitur me një shije të re, veçanërisht për vizatimet dhe motivet kineze, një stil i ri arti u përhap në të gjitha tokat islame. Kjo është koha e një krijimtarie të shkëlqyer, në të cilën disa teknika pararendëse arritën lartësinë e tyre më të madhe dhe mënyra të reja të shprehjes artistike u shpikën. Kjo periudhë, gjithashtu, është e shënjuar nga patronë të mëdhenj dinastikë, shpesh të huaj në tokat e tyre, të cilët kërkonin të legjitimonin sundimin e tyre dhe të theksonin dashurinë për artin nëpërmjet sponsorizimit të tij.

Ndoshta impakti më i thellë që pati pushtimi mongol tek artet në Iran, ishte roli i ri ilustrimit të dorëshkrimeve, i cili u bë një tribunë domethënëse dhe shumë ndikuese për patronatin e oborrit. Duke nisur nga fillimshkulli XIV, vëmendja kryesore e patronatit Ilkhanid u zhvendos mbi punimet historike dhe poemat epike. Koleksione të ndryshme dorëshkrimesh të ilustruara me ngjyra në muze dhe biblioteka të ndryshme ruhen nga Shahnameja e Firdusiut, nga Hamsa (Kuinteti) një poemë romantike e shek. XII e Nizamiut etj. Ky lloj mediumi nuk u përdor vetëm nga ilkhanidët, por u prodhua edhe nën patronatin e dinastisë turkmene të Dashit të Bardhë (Ak Kojunllu) dhe shumë prej tyre vijnë edhe nga Herati

i timuridëve. Nastaliku, një lloj shkrimi i varur i dallueshëm lehtë, u zhvillua gjatë kësaj periudhe; ai përdorej kryesisht për të kopjuar poezinë persiane, jo vetëm për në letër, por edhe në mbishkrime mbi një numër të ndryshëm objektësh. Tekstet persisht të kësaj periudhe dhe në periudhën e mëpasme të vonët islame shumë shpesh u kopjuan me këtë shkrim të rafinuar e elegant.

Mamlukët ishin patronë të jashtëzakonshëm të arteve. Ata treguan një interes të veçantë në ndërtimin e vakëfeve dhe ndërtesave fetare, të cilat i furnizuan me të gjitha nozullimet e shtrenjta dhe të bukura. Shirita të zinj me thuluth u bënë elementi kryesor i zbukurimit në punimet metalike mamluke të shek. XIV. Pushtimet mongole në Azinë lindore dhe perëndimore në fillim dhe në mes të shek. XIII patën një impakt të pamatshëm në shoqëritë e asaj kohe. Megjithëse mamlukët i ndalën forcat mongole në 1260 në Ajn Xhalut, në Palestinë, gjuha e re artistike e frymëzuar nga kinezët dhe që u zhvillua në Iranin e Madh, si pasojë e sundimit mongol, depërtoi lehtësisht në artin dhe kulturën mamluke. Kontakte direkte nëpërmjet objekteve të importuara kineze, si tekstilet dhe porcelanet bardhë-e-blu në shek. XIV ndihmuan, gjithashtu, në përhapjen e një fjalori të pasur pamor tek artistët mamlukë. Imitimet e porcelaneve kineze të prodhuara në Sirinë e fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV ndikuan, gjithashtu, te poçarët mamlukë që të prodhojnë pllaka veshjeje me ngjyrë blu kobalti (ndonjëherë të zeza dhe ndonjëherë ngjyrë bruzi me bordura jeshile) në sfond të bardhë. Zbukurimi i këtyre pllakave gjashtëkëndore kombinon tipikisht me motivet bimore me frymëzim kinez dhe me parapëlqimin islam për simetrinë dhe vizatimet gjeometrike.

Pallati i madh qytet i Alahambres është arritja më e madhe unikale e dinastisë nasride të Spanjës. Alhambra, ky emër është një bastardim i al-Hamra (e kuqe), mund t'i referohet ngjyrës së kuqe të mureve, është e vendosur lart në majë të një kodre, nga ku e mbikëqyr qytetin e Granadës. E ideuar njëkohësisht si pallat mbretëror dhe pallat i fortifikuar, Alhambra mbrohej nga mure me gurë të rëndë dhe kulla nga jashtë, të cilat mbanin fshehur dhoma të vendosura njëra pas tjetrës dhe të zbukuruara, oborre, kopshte dhe çizma dekorative nga brenda. Ambientet e brendshme të Alahambres janë të zbukuruara pasurisht me



elemente arkitekturore të derdhura me llaç, me pllaka porcelani të zbukuruar dhe tekstile të kësaj periudhe. Ndërsa një pjesë e tekstileve, që kanë mbijetuar nga koha e nasridëve, tregojnë për luksin dhe motivet e ndërlikuara që kanë përdorur në qëndisjen dhe zbukurimin e tyre.

### **Periudha e vonët islame**

(shek. XVI e deri në fund të shek. XVIII)

Ndoshta më tepër se sa në periudhat e mëhershme, arti ka qenë një instrument shprehës dinastik në këto kohëra të perandorive të mëdha. Nxitur nga patronati mbretëror, artet lulëzuan nën Osmanët dhe Safavidët. Sulmet ushatarake osmane në Iranin e fundshekullit XV dhe përgjatë gjithë shek. XVI, çuan në përvetësimin prej artistëve të punimeve artistike dhe të ideve të ndryshme. Artet dekorative osmane dhe arti i librit u pasuruan kështu me repertorin e motiveve bimore e floreale, i zhvilluar fillimisht në Iranin e shek. XV, të cilit i referohen përgjithësisht si stili ndërkombëtar timurid. Gjithashtu, në shek. XVI shumë artistë, me dëshirën e tyre, emigruan nga Irani në Indi, duke eksportuar kështu edhe stilin e ilustrimit të librave që dha një kontribut në zhvillimin e një gjuhe të re dhe të dallueshme artistike mogule. Për shumë nivele kjo ka qenë një periudhë ndërkombëtare, ku arti osman, safavid dhe mogul patën impakt me estetikën e stabilizuar në Iranin e shek. XV.

Periudha e vonshme islame i përket kohës së perandorive, kur bota islame qeverisej nga tri dinasti të fuqishme: Safavidët në Iran; Mogulët në Indi; dhe më e madhja e dinastive të Islamit të vonët, Osmane, e cila sundoi mbi Anadollin, tokat arabe dhe në një pjesë të madhe të Evropës Lindore. Megjithëse Osmanët tashmë e kishin nën kontroll pjesën më të madhe të këtyre territoreve, duke nisur që nga viti 1453, koha kur pushtuan Kostandinopojën (më pas Stamboll), të cilën e kthyen në kryeqytetin e tyre, shek. XVI do të ishte koha e artë për ta. Në vitin 1517 perandoria mamluke do t'u nënshtrohej atyre dhe, nga mesi i shek. XVI, kontrolli osman do të shtrihej nga Evropa Qendrore deri në Oqeanin Indian. Perandoria Osmane arriti kulmin e saj të fuqisë ushtarake dhe politike nën sundimin e Sulejman Kanunit (Madhështori, s. 1520-1566),

ushtritë e të cilit përparuan deri në dyert e Vjenës. Mbretërimin të Sulejmanit i përkasin disa nga arritjet më të mëdha të **arkitekturës osmane**, veçanërisht xhamitë vigane dhe të pakrahasueshme, si dhe vakëfet që ai ngriti në Stamboll. Gjatë sundimit të tij u ngritën jo vetëm xhamitë vigane, por edhe një sërë veprash të tjera civile, si: ujësjellës, ura etj. Sulltan Sulejmani dhe familja e tij u treguan se ishin patronë të lartë dhe të përkushtuar për artet dhe arkitekturën, ashtu siç ishin edhe pushtetarë të mëdhenj. Vetë sulltan Sulejmani ka shkruar poezi të ndjera për bashkëshorten e vet, Hurrem Sulltanën.

Fuqia osmane filloi të bjerë në shekullin në vijim pas vdekjes së Sulejmanit. Për herë të parë, ushtria osmane pësoi një disfatë të madhe ushtarake nga evropianët, fuqia ushtarake dhe ekonomike e të cilëve vazhdoi t'i përmbysë Osmanët edhe në shek. XVIII. Perandoria u shpërbë përfundimisht me disfatën e Osmanëve gjatë Luftës së Parë Botërore, ku vetëm Anadulli mbeti nën sundimin turk.

Në fillim të shek. XVI Irani u bashkua nën sundimin e dinastisë Safavide, anëtarët e së cilës pretendonin se e kishin prejardhjen nga Shejh Safiu, një sufi, i cili themeloi një tarikat dervishësh në Erdebil, në veriperëndim të Iranit. Më 1501 Ismail Safaviu futi nën kontrollin e vet Iranin Veriperëndimor, duke ia marrë fisit turk Ak Kojunllu (Dashi Bardhë) dhe u proklamua si shahu i parë safavid në Tabriz, kryeqyteti i ri. Ismaili vendosi Shiizmin si fenë zyrtare të Shtetit Safavid, i cili në atë kohë kufizohej vetëm me krahinën e Azerbajxhanit. Brenda një dhjetëvjeçari do të futej i gjithë Irani nën kontrollin safavid. Më i madhi nga të gjithë sundimtarët safavidë ishte Shah Abazi (s. 1587-1629), i cili trashëgoi një mbretëri të trazuar nga telashet ushtarake, politike dhe financiare. Si pjesë të reformave të tij politike dhe fiskale, Shah Abazi e transferoi kryeqytetin e tij në Isfahan, Iranin Qendror, ku ai ndërtoi një qytet të ri, duke e bashkuar me atë të vjetrin. Shah Abazi vendosi lidhje tregtare me Evropën, ku Irani eksportonte mëndafsh, qilima, tekstile dhe qeramika. Nën sundimin e Shah Abazit, Irani u ngrit lart si fuqi, në begati e pasuri. Megjithëse pasardhësit nuk ia dolën t'i tejkalojnë apo t'i kapin këto arritje, ato vazhduan në këtë rrugë edhe për një shekull tjetër, deri në rënien e dinastisë safavide më 1732.